



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

BORDI

VENDIM

Nr. 76, Datë 19.03.2021

MBI

**ZGJATJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
KËRKESËN E SHOQËRISË “E-VENTO S.R.L ALBANIA” SH.P.K, PËR
RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 32, DATË 04.02.2021**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 92, pika 1 dhe 2, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 15 dhe 16, të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s; miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 8, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 37/2 prot., datë 17.03.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 32, datë 04.02.2021, vendosi:
 1. Mospranimin e kërkesës së shoqërisë “E-VENTO S.R.L. ALBANA” sh.p.k., për zgjatjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar.
 2. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “E-VENTO S.R.L ALBANA” sh.p.k., nr. 60, seria NPM08P.
 3. Shoqëria “E-VENTO S.R.L. ALBANA” sh.p.k. ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
- Shoqëria “E-VENTO S.R.L. ALBANA” sh.p.k., është njoftuar për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën e ERE-s nr. 16/1 prot., datë 11.02.2021, nëpërmjet së cilës është informuar se ka 30 ditë kohë për të paraqitur argumentet e saj të mundshme me shkrim nga marrja e kësaj shkrese.
- Brenda afatit 30 ditor brenda të cilit shoqërisë i është dhënë e drejta për t’u përgjigjur me shkrim, ajo ka depozituar shkresat e protokolluara në ERE me nr. 16/2 prot., datë 18.02.2021, si dhe nr. 16/3 prot., datë 22.02.2021, me anë të të cilave ka kërkuar rishikimin e vendimit nr. 32, datë 04.02.2021.
- Së fundi, me e-mailin e datës 15.03.2021, në emrin e shoqërisë “E-VENTO S.R.L ALBANIA” sh.p.k., është depozituar gjithashtu dokumentacion shtesë. Duke qenë se

kërkesa e depozituar është në formatin word dhe i panënshkruar, e po ashtu duke qenë se bashkëlidhur ka dhe dokumentacion në anglisht, për shkak se mund të ndodhemi përballë rrethanave apo fakteve të reja, vlerësojmë se nevojitet të vendoset kontakti me subjektin për të përcjellë dokumentacionin në formën e kërkuar.

- Në nenin 8, të *Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për bordin mbi argumentet e paraqitur dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t'i paraqesin bordit propozimin përkatës.
- Në përmbushje të afatit 30 ditor për të përgatitur relacionin përkatës mbi argumentet e paraqitura nga shoqëria, duke marrë në konsideratë dhe kohën që nevojitet për të vendosur kontaktin me shoqërinë për të saktësuar e përcjellë sipas formës ligjore dokumentacionin e ardhur së fundi, si dhe kohën që nevojitet për të shqyrtuar këtë dokumentacion, e po ashtu duke marrë në konsideratë dhe rrethanat e krijuara nga COVID-19, u vlerësua e nevojshme zgjatja me 30 ditë pune e afatit vendimmarrjes së bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë për rishikimin e vendimit nr. 32/2021.
- Në nenin 92, pika 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:
 1. *Përveç kur ndalohet shprehimisht nga ligji, në raste të justifikuara, për shkak të kompleksitetit të çështjes, organi publik mund të zgjasë vetëm një herë afatin e përcaktuar sipas nenit 91, të këtij Kodi.*
 2. *Zgjatja e afatit bëhet për aq sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës, në proporcion me vështirësinë e çështjes konkrete, por jo më shumë se kohëzgjatja e afatit fillestar.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “E-VENTO S.R.L ALBANIA” sh.p.k, për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 32, datë 04.02.2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes si dhe Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI